

PRISHTINA



*KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA*

Në bazë të nenit 14 të Ligjit mbi tokën ndërtimore (“Gazeta zyrtare e Kosovës”, nr.14/80 dhe 42/86), nenit 34, paragrafi 1 i Ligjit për ndërtim, nr.2004/37 dhe nenit 19, paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të datës 16 mars 2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.06.2005, mori

V E N D I M
P Ë R
PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR DHËNIEN E TOKËS NDËRTIMORE NË
SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHËM PËR NDËRTIMIN - VENDOSJEN E
OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME

Neni 1

Në Rregulloren për dhënie e tokës ndërtimore në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin - vendosjen e objekteve të përkohshme 01 nr. 010-2, të 03.01. 2002, në nenin 2, paragrafi 3, pas fjalëve: “Panot dhe tabelat reklamuese” shtohen fjalët:

- “ekranet elektronike reklamuese”.

Pas fjalëve: “Strehët për pritje të autobusëve”, shtohen fjalët:

- “gjeneratorët statik”,
- “lojrat në autoparqe”.

Neni 2

Në nenin 2, paragrafi 4, pas fjalëve: “Tavolinat lëvizëse për shitjen e lotarive, të urimeve, panoramave dhe fotografive artistike, librave, bizhuterisë, lojrave të fatit, e të ngjashme”, shtohen fjalët:

- “automjetet lëvizëse për shitjen e ushqimit të shpejtë”,
- “tendat (çadrat) e hapura lëvizëse me mekanizëm”.

Neni 3

Pas nenit 30, shtohet neni i ri 30 a, i cili thotë:

“Përveç kushteve nga neni 26, 27, 28, 29 dhe 30 të kësaj Rregulloreje, kërkuesi duhet të paraqesë edhe këtë dokumentacion:

Për vendosjen e kabinave (foltoreve) telefonike:

- certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- licencën nga Ministria e Transportit dhe e Postë- Telekomunikacionit,
- lejën e punës (nga Drejtorati i Ekonomisë),
- skicën e lokacionit,
- atestën e qëndrueshmërisë (statika, tokëzimi).

Për vendosjen e ekraneve elektronike reklamuese:

- certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- lejen e punës (nga Drejtorati i Ekonomisë),
- projektin e lokacionit me skicë,
- pëlqimin urbanistik,
- atestimin teknik dhe elektronik,
- statikën dhe peshën e ekranit,
- fotokopjen e letërnjoftimit të pronarit.

Për vendosjen e gjeneratorëve statik:

- certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- lejen e punës (nga Drejtorati i Ekonomisë),
- pëlqimin nga organi kompetent i Bashkësisë lokale
- specifikat e gjeneratorit (lloji),
- atestimin mbi mbrojtjen nga rreziqet (nga Drejtorati i Mbrojtjes Civile dhe i Emergjencës),
- atestimin për mbrojtje nga zhurma,
- skicën e lokacionit.

Për vendosjen e lojërave në hapësirën publike:

- certifikatën e regjistrimit të biznesit.
- skicën e lokacionit,
- lejen e punës (nga Drejtorati i Ekonomisë),
- fotokopjen e letërnjoftimit të pronarit,

Për vendosjen e automjetit lëvizës për shitjen e ushqimit të shpejtë:

- certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- konfirmimin nga Drejtorati i Inspeksionit për plotësimin e kushteve higjieno-sanitare,
- skicën e lokacionit,
- certifikatën për kualifikimin përkatës për ushtrimin e profesionit,
- fotokopjen e letërnjoftimit të pronarit.

Për vendosjen e tendave (çadrave) të hapura lëvizëse me mekanizëm:

- certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- lejen e punës (nga Drejtorati i Ekonomisë),
- skicën e lokacionit,
- fotokopjen e letërnjoftimit të pronarit”.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINË
01 Nr. _____ datë _____ 2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri